



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 187, datë 31.10.2022

PËR
SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT TË BORDIT
NR. 88, DATË 28.04.2022 “MBI PRITSHMËRITË RREGULLATORE PËR TREGUN E
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE (SIK)”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikat 2 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Shtyrjen e afatit të Vendimit të Bordit nr. 88, datë 28.04.2022 “Mbi pritshmëritë rregullatore për tregun e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK)”, i ndryshuar, deri më 30 Qershor 2023.**
- 2. Shoqëritë administruese të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive të depozitojnë në Autoritet rezultatet e provave të rezistencës të kryera çdo 3 muaj, për secilin fond nën administrim, duke filluar nga muaji Shtator 2022.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE